REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Br. 978/20
Datum. 16.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.978/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "ASTRAPLAN" SH.P.K – Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i rrethojës së sigurisë për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë", me nr. të prok. 214-20-7472-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Ministria e Punëve te Brendshme", më datën: 15.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "ASTRAPLAN" SH.P.K –Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i rrethojës së sigurisë për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë", me nr. të prok. 214-20-7472-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Ministria e Punëve te Brendshme".

II. **ANULOHET**, njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i rrethojës së sigurisë për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë", me nr. të prok. 214-20-7472-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Ministria e Punëve te Brendshme", me rastin e ri-tenderimit, AK të hartoj kërkesat në përputhje me sqarimet e ekspertit dhe duke respektuar ne tërësi ligjin dhe rregullat dytësore për prokurim publik.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "ASTRAPLAN" SH.P.K –Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "ASTRAPLAN" SH.P.K –Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 19.11.2020 me nr. 978/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i rrethojës së sigurisë për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë", me nr. të prok. 214-20-7472-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Ministria e Punëve te Brendshme", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 28 (pikat 2,3,4,5), 51, 69 (pika 6 -6.1 – 6.5 – 6.6) 70, 72, dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 18.9 dhe 26.4 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 04.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është kërkuar: "Së paku një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me kualifikim diplome si International Welding Specialist (IWS). Inxhinieri duhet te ketë përvojë pune ne lëmin e saldimeve se paku 3 vite. Diploma e IWS duhet te jete e akredituar ne International Welding insitute (IIË)- Instituti ndërkombëtar i Saldimit".

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: "Diploma e noterizuar nga origjinali, - diploma e IWS e noterizuar nga origjinali; - CV; -Kontrata-marrëveshja e punës valide me punëdhënësin-kopje, -referencat qe dëshmojnë për punët e kryera dhe përvojën ne projekte te natyrës se ngjashme-kopje".

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë si dhe aktivitetin e prokurimit i cili aktivitet ka të bëjë me Rregullim të rrethojes, eksperti shqyrtues sqaron se duhet të HIQET pjesa: "Me

kualifikim diplome si International Welding Specialist (IWS) dhe Diploma e IWS duhet të jete e akredituar ne International Welding insitute (IIË)- Instituti ndërkombëtar i Saldimit", dhe të MBETET pjesa: "Së paku një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, edhe të kërkohet si kriter shtesë një SALDUES. Ky ndyshim duhet të bëhet për të pasur sa më shumë konkurrencë dhe të ju jepet mundësi që të ofertojnë edhe kompani të reja, si dhe duke pasur parasysh që nuk kërkohen rrethoja speciale, mendoj se nuk ka nevoj që saldues me certifikim nërkombëtarë. Gjithashtu të përmisohet pjesa tek dëshmit dokumentare, të hiqet pjesa e dëshmive të kërkuara për kualifikimin "International Welding Specialist (IWS)".

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është kërkuar: "Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një ekspert për ITIL v3 EXPERT".

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: "Certifikatat - dëshminë e kualifikimit për ITIL v3 EXPERT - kopje , -CV; - kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin-Kopje".

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, natyrën e aktivityetit të prokurimit, eksperti shqyrtues sqaron se kualifikimit për ITIL v3 EXPERT, mendoj se është një certifikim especifik, nga një shtet i caktuar, andaj duhet të jetë certiikimi për ITIL v3 EXPERT ose certifikime ekujvalent.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është kërkuar: "Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një Ekspert për Sigurimin e Cilësisë".

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: "Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një ekspert për ITIL v3 EXPERT - kopje , -CV; - kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin-Kopje", e njëjta dëshmi me dëshmin e kërkuar tek kërkesa nr.6, ku mendoj që është bërë ndonjë gabim.

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, natyrën e aktivitetit të prokurimit, eksperti shqyrtues sqaron se mund të mbetet Eksperti për Sigurimin e Cilësisë, mirëpo të elaborohet (sqarohet) çfarë fushe është eksperti në fjalë, çfar kualifikimi të ketë. Si dhe të përmisohet pjesa tek dëshmit dokumentare sepse është e njëjtë me dëshmit e kërkuara për kërkesën me nr. 6.

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: "Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion Dy (2) teknik të certifikuar nga prodhuesi për CCTV".

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: "Certifikatat - dëshminë e kualifikimit për CCTV - kopje , -CV; - kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin-Kopje.
Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se akronimi CCTV, nuk është emër i ndonjë prodhuesit, por certifikim për CCTV.

Përgjigje në Pretendimi nr. 5
Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: "Operatori ekonomik, për pozicionet e CCTV Sistemi i kamerave, duhet të ofroj MAF nga prodhuesi".
Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: "MAF-i (Manufacturer Authorisation Form direct nga prodhuesi të skanohet nga Origjinal) për pozicionet Sistemi i kamerave".

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrues sqaron se përveq kërkesës që për pozicionet e CCTV Sistemi i kamerave, duhet të ofroj MAF nga prodhuesi, duhet të jetë edhe nga Distributori, po ashtu të përmisohet e dhe pjesa të dëshmit dokumentare.

Përgjigje në Pretendimi nr. 6
Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është kërkuar: "Kamion me vinç dhe platformë (korpe) deri 30m".
Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: "Kopjen e librezës qe e ka ne pronësi (ose kontrate mbi shfrytëzimin e pajisjeve – me qera me ndonjë operator ekonomik- kontrata e noterizuar) me dëshmitë e pronësisë".
Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa "Kamion me vinç dhe platformë (korpe) deri 30m", NUK është kërkesë diskriminuese (kufizuese), sepse me sa kuptojë une Kamion me vinç dhe platformë (korpe), mund të jetë 1m min deri në 30m maxi, pra maksimumi është 30m.
Eksperti shqyrtues sqaron se në nenin 18.9 të RRUOPP-së, thuhet: "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë EO-ve".

Mendimi i ekspertit shqyrtues :Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të bëhen ndryshimet e duhura, të njoftohen palët me ndryshimet dhe të vazhdohet më tutje me aktivitetin e prokurimit.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 07.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Ministria e Punëve te Brendshme , e ka shqyrtuar dhe vlersuar Raportin e ekspertit shqyrtues i autorizuar nga OSHP-ja lidhur me ankesen e dorëzuar numer 978/20 ne OSHP nga Operatori Ekonomik "Astraplan"shpk Prishtinë, te daes 16/11/2020lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i rrethojës së sigurisë për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë", me nr te prok: 214-20-7472-5-2-1, kunder njoftimit per kontrat te dates 11.11.2020ne platformen elektronike.

AK, nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues , sepse Publiktimi i tenderit , perkunder pretendimeve nga Operatori Ekonomik ankues eshte ne përputhje me LPP-së, per te cilat pretendime kemi dhene pergjigije ne vendimin mbi kerkesen per Rishqyrtim te datës 19.11.2020

Operatori Ekonomik: me datë: 08.12.2020, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Ne si OE pajtohemi pjesërisht me ekspertizen , me saktësisht pajtohemi me pergjigjet ne pretendimet ankimore me nr. 1, 3, 4, 5, dhe 6,

Ndërsa nuk pajtohemi me pergjigjen ne pretendim ankimor me nr 2 sepse ajo terkes është jashtë çdo logjike dhe nuk ka te beje fare me projektin , dhe për ata duhet te hiqet qe mos te kufizohet konkurrenca

Deshmit dhe argumentet tona do ti paraqesim ne seancën kryesore pran PSH.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "ASTRAPLAN" SH.P.K –Prishtinë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është kërkuar: "Së paku një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me kualifikim diplome si International Welding Specialist (IWS). Inxhinieri duhet te ketë përvojë pune ne lëmin e saldimeve se paku 3 vite. Diploma e IWS duhet te jete e akredituar ne International Welding insitute (IIË)- Instituti ndërkombëtar i Saldimit".

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: "Diploma e noterizuar nga origjinali, - diploma e IWS e noterizuar nga origjinali; - CV; -Kontrata-marrëveshja e punës valide me punëdhënësin-kopje, -referencat qe dëshmojnë për punët e kryera dhe përvojën ne projekte te natyrës se ngjashme-kopje".

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, si dhe aktivitetin e

prokurimit i cili aktivitet ka të bëjë me Rregullim të rrethojës, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duhet të largohet pjesa: "Me kualifikim diplomë si International Welding Specialist (IWS) dhe Diploma e IWS duhet të jete e akredituar ne International Welding insitute (IIË)- Instituti ndërkombëtar i Saldimit".

Ndërsa, të mbetet pjesa: "Së paku një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, edhe të kërkohet si kriter shtesë një SALDUES.

Paneli Shqyrtues sqaron se ky ndryshim duhet të bëhet me qëllim të rritjes së konkurrencës dhe të ju jepet mundësi që të ofertojnë edhe kompani të reja. Duke pasur parasysh që nuk kërkohen rrethoja speciale, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se nuk ka nevojë për saldues me certifikim ndërkombëtarë. Gjithashtu, të përmirësohet pjesa tek dëshmitë dokumentare, ku duhet të hiqet pjesa e dëshmive të kërkuara për kualifikimin "International Welding Specialist (IWS)".

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues "ASTRAPLAN" SH.P.K –Prishtinë, që ka të bëjë me ekspert për ITIL, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është kërkuar: "Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një ekspert për ITIL v3 EXPERT".

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: "Certifikatat - dëshminë e kualifikimit për ITIL v3 EXPERT - kopje , -CV; - kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin-Kopje".

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, natyrën e aktivitetit të prokurimit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kualifikimit për ITIL v3 EXPERT, është një certifikim specifik nga një shtet i caktuar. Andaj, duhet të jetë certifikimi për ITIL v3 EXPERT ose certifikime ekuivalent.

Lidhur me pretendimin e radhës të OE ankues "ASTRAPLAN" SH.P.K –Prishtinë, që ka të bëjë me kërkesën për ekspert për sigurimin e cilësisë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është kërkuar: "Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një Ekspert për Sigurimin e Cilësisë".

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: "Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një ekspert për ITIL v3 EXPERT - kopje , -CV; - kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin-Kopje", e njëjta dëshmi me dëshminë e kërkuar tek kërkesa nr.6, duhet të jetë bërë ndonjë gabim.

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, natyrën e aktivitetit të prokurimit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se mund të mbetet eksperti për sigurimin e cilësisë, mirëpo të elaborohet (sqarohet) çfarë fushe është eksperti në fjalë, çfarë kualifikimi të ketë. Si dhe të

përmisohet pjesa tek dëshmitë dokumentare sepse është e njëjtë me dëshmitë e kërkuara për kërkesën me nr. 6.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues "ASTRAPLAN" SH.P.K –Prishtinë, që ka të bëjë me dy teknikës e certifikuar nga prodhuesi CCTV, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: "Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion Dy (2) teknik të certifikuar nga prodhuesi për CCTV".
Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: "Certifikatat - dëshminë e kualifikimit për CCTV - kopje , -CV; - kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin-Kopje.
Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se akronimi CCTV, nuk është emër i ndonjë prodhuesit por certifikim për CCTV.

Pretendimi tjetër i OE ankues "ASTRAPLAN" SH.P.K –Prishtinë ka të bëjë me kërkesën: "Operatori ekonomik, për pozicionet e CCTV Sistemi i kamerave, duhet të ofroj MAF nga prodhuesi".
Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: "MAF-i (Manufacturer Authorisation Form direct nga prodhuesi të skanohet nga Origjinal) për pozicionet Sistemi i kamerave".
Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, Paneli Shqyrtues konform ekspertir shqyrtues sqaron se përveç kërkesës që për pozicionet e CCTV Sistemi i kamerave, duhet të ofroj MAF nga prodhuesi, duhet të jetë edhe nga Distributori, po ashtu të përmirësohet edhe pjesa të dëshmitë dokumentare.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "ASTRAPLAN" SH.P.K –Prishtinë që ka të bëjë me kërkesën e AK-së: "Kamion me vinç dhe platformë (korpe) deri 30m".
Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: "Kopjen e librezës qe e ka ne pronësi (ose kontrate mbi shfrytëzimin e pajisjeve – me qera me ndonjë operator ekonomik- kontrata e noterizuar) me dëshmitë e pronësisë".
Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa "Kamion me vinç dhe platformë (korpe) deri 30m", nuk është kërkesë diskriminuese (kufizuese), sepse kamion me vinç dhe platformë (korpe), mund të jetë 1m min. deri në 30m maxi, pra maksimumi është 30m.
Paneli shqyrtues, sqaron se AK duhet te vendos kriteret ne harmoni me LPP-në dhe RrUOPP-në, përkatësisht dispozitat e përshkruara në to dhe mos te favorizohet apo diskriminohen OE, sepse kjo ndikon qe te dëmtohet edhe buxheti i AK-së, Pra, AK te vendos kritere te matshme sipas LPP-se dhe RrUOPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues gjatë ndryshimit dhe përmirësimit të dosjes duhet të ketë parasysh edhe nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP) ku shkruan "*Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. "Të arsyeshme dhe të mjaftueshme" do të nënkuptoj në lidhje me:*

(i). vlerën e parashikuar të kontratës, dhe

(ii). përdorim të drejtë të fondeve publike.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK duke përdorur kritere diskriminuese në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, po ashtu këto kritere janë në kundërshtim me nenin 1, 6, 51 dhe 69.8 të LPP-së, si dhe nenin 18.9 te RRUOPP-së. Kjo me qëllim të ofrimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit në këtë aktivitet të prokurimit. Pra, AK duhet ti bëjë korrigjimet e duhura përkitazi me sqarimet e mësipërme.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "MPB";

1x1 OE "ASTRAPLAN" SH.P.K;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.